



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr. 35, datë 09. 10. 2012

**PËR
“DISA NDRYSHIME NË BUXHETIN E BASHKISË SË TIRANËS PËR VITIN
2012”**

Në mbështetje të nenit 19, pika 2 dhe 9 dhe nenit 32, gërma “dh” të ligjit nr.8652 datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, ligjit nr.9936 datë 26.06.2008, për “Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, pikën 97 të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 2, datë 06. 02. 2012 për “Proçedurat standarde të zbatimit të buxhetit”; vendimit të Këshillit Bashkiak të Tiranës nr. 25 datë 28.12.2011 për “Miratimin e Buxhetit të vitit 2012”, vendimit të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve nr. 4, datë 18.05.2012, për “Shpërndarjen e fondeve të zhvillimit të rajoneve”, shkresës së Këshillit të Ministrave nr.1560, datë 04.06.2012, “Njoftim për miratimin e projekteve nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve” dhe shkresës së Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës me nr. 3185/3, datë 04.06.2012, “Mbi miratimin e vlerave të plota të objekteve nga Komiteti i Zhvillimit të Rajoneve, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I

1. Të miratojë disa ndryshime në vlerën e investimeve, të buxhetit të Bashkisë së Tiranës, në programin e Menaxhimit të Rrugëve dhe Transportit Publik, programin e Arsimit Parauniversitar dhe Edukimit dhe në programin e Shërbimeve Publike Vendore, për projektet e miratuara nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve, sipas tabelës nr.1 bashkëlidhur, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Të miratojë shtesën në fondin e investimeve të buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2012, për projektet e miratuara nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve për këtë vit, në programin e Menaxhimit të Rrugëve dhe Transportit Publik, programin e Arsimit Parauniversitar dhe Edukimit dhe në programin e Shërbimeve Publike Vendore, sipas tabelës nr.2 bashkëlidhur, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Të miratojë ndryshimet në fondin e investimeve të buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2012, nga të ardhurat e Bashkisë së Tiranës, brenda programit të Menaxhimit të Rrugëve dhe Transportit Publik, sipas tabelës nr.3, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
4. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Menaxhimit të Shërbimeve, Drejtoria e Planifikimit Strategjik, Drejtoria e Prokurimeve, Drejtoria e Financës për zbatimin e këtij vendimi
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë mbas shpalljes.

K R Y E T A R I

Niazi KOSOVRASTI